

REZOLUTË

PËR NJOHJEN DHE FORCIMIN E ROLIT TË SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN E ZHVILLIMEVE DEMOKRATIKE TË VENDIT

Kuvendi i Shqipërisë:

Në mbështetje të parimeve të shprehura në rezolutën “Për procesin e integritimit Europian të Shqipërisë”, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 27 nëntor 2013;

Në mbështetje të rekomandimit (2007)14 të Këshillit të Ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Europës “Mbi statusin ligjor të organizatave joqeveritare në Europë”;

Duke mbajtur parasysh se ekzistenca dhe fuqizimi i një shoqërie civile është jo vetëm shprehje e një demokracie pluraliste, por domosdoshmëri për një qeverisje demokratike dhe transparente;

Duke marrë në konsideratë faktin që dialogu politik i realizuar nëpërmjet gjithëpërfshirjes dhe transparencës, përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile e partnerët socialë, është i rëndësishëm për progresin e vendit në zhvillimin e reformave dhe konsolidimin e demokracisë, si dhe në procesin integruar në Bashkimin Europian;

Duke njohur faktin se shoqëria civile përbëhet nga tërësia e organizatave jofitimprurëse, grupime qytetarësh që përfaqësohen nëpërmjet sindikatave, organizimeve të biznesit, konsumatorëve, organizatave fetare, etnike, lëvizjeve sociale, mediave, si dhe të gjitha grupet e individëve ose individët që janë aktivë në sferën publike dhe që ushtrojnë veprimtari në të mirë dhe interes të publikut dhe se zhvillimi i tyre është një domosdoshmëri për një shoqëri demokratike;

Duke mbajtur parasysh angazhimet që rrjedhin nga dhënia e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë në qershor të këtij viti, si dhe vlerësimet dhe rekomandimet e bëra në Raport Progresin e fundit për Shqipërinë të Komisionit Europian (tetor, 2014), në të cilin:

- Vërehet se bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) është përmirësuar;

- Shoqëria civile është konsultuar rregullisht mbi politikat dhe nismat ligjore, edhe pse zbatimi i rekomandimeve të tyre ka qenë i kufizuar;

- Konsultimet me OSHC-të duhet të bëhen më sistematike dhe me transparencë, si edhe të zbatohen rekomandimet e tyre;

- Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve dhe njësisë të qeverisjes vendore nuk është në nivelin e duhur, për shkak të mungesës së kapaciteteve të nevojshme për të garantuar bashkëpunimin dhe financimin e duhur për OSHC-të;

- Vlerësohet se përbën sfidë kryesore për autoritetet shqiptare zhvillimi i një procesi konsultativ gjithëpërfshirës i institucionalizuar, transparent, më sistematik dhe në kohë me shoqërinë civile, në procesin e hartimit të politikave, nismave ligjore dhe zbatimit të tyre.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

Kontributin e dhënë nga shoqëria civile në drejtëm të respektimit, promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, forcimit të shtetit të së drejtës dhe të një shoqërie të drejtë, të hapur dhe demokratike në vendin tonë; në iniciimin e nismave ligjore për hartimin e ligjeve të reja, përmirësimin dhe zbatimin e tyre; në ofrimin e mbështetjes së personave në nevojë, në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të administratës publike, në monitorimin e respektimit të standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare në fusha të ndryshme, në ndërgjegjësimin e publikut për rolin e tij në një shoqëri demokratike etj.;

Kontributin e shoqërisë civile në procesin integruar të vendit në Bashkimin Europian, në forcimin e bashkëpunimit dhe kohezionit social në rajon dhe më gjerë;

Rolin vendimtar që ka Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendi i Shqipërisë në forcimin dhe zgjerimin e mundësive pjesëmarrëse të aktorëve të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit, konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe rritjen e transparencës në vendimarrjen publike;

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet në:

- Realizimin e procesit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, bazuar në parimet e pjesëmarrjes dhe përfshirjes, respektit dhe reciprocitetit, partneritetit, përgjegjshmërisë dhe pavarësisë;

- Zhvillimin e një procesi konsultimi transparent dhe gjithëpërfshirës me aktorë të shoqërisë civile e grupet e interesit në procesin ligjvënës, duke garantuar transparencën, pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;

- Nxitjen dhe mbështetjen e nismave që kanë si qëllim fuqizimin dhe promovimin e bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe institucioneve publike, në mënyrë të veçantë me njësitë e qeverisjes vendore, duke inkurajuar zhvillimin e një dialogu të hapur, konstruktiv dhe një klimë mirëbesimi mes tyre;

- Nxitjen dhe mbështetjen e nismave që kanë si qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve dhe shoqërisë civile, për të ndikuar në hartimin e politikave, legjislacionit e në zbatimin e tyre, si dhe në proceset vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor;

- Nxitjen dhe mbështetjen e nismave që kanë si qëllim rritjen dhe forcimin e përfshirjes së shoqërisë civile në adresimin e çështjeve që janë pjesë e agjendës reformuese të integritetit të Shqipërisë;

- Nxitjen dhe mbështetjen e nismave ligjvënëse për përmirësimin e kuadrit ligjor që kanë si qëllim krijimin e kushteve për fuqizimin, zhvillimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e nevojshme financiare të organizatave të shoqërisë civile, si dhe krijimin e mekanizmave dhe parashikimin e procedurave të qarta për përfaqësimin e tyre në procesin vendimmarrës;

- Nxitjen dhe mbështetjen e nismave ligjvënëse për forcimin e pavarësisë, transparencës dhe efikasitetit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, si dhe mbi rolin e saj për lehtësimin e procesit të bashkëpunimit midis sektorit të shoqërisë civile dhe Qeverisë.

Miratuar në datën 24.12.2014

KRYETARI
Ilir Meta